



së Mjedisit dhe Ministrisë së Financave, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Mjedisit t'i shtohet fondi për shpenzime korrente, në masën 41 000 000 (dyzet e një milionë) lekë, në programin 05320, "Mbrojtja e mjedisit", për të përballuar pjesërisht kostot e ekspertimit e të përfaqësimit të avokatëve të kontraktuar nga ana e shtetit shqiptar për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar ICSID, nr.ARB/14/26, me palë "Albaniabeg Ambient", sh.p.k., M.Angelo Novelli dhe "Costruzioni", s.r.l, kundër Shqipërisë;

b) Ministrisë së Financave, në zërin "shpenzime korrente", t'i pakësohen fondet, përkatësisht:

i) 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, në programin 01110 "Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi";

ii) 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekë, në programin 01120 "Menaxhimi i shpenzimeve publike".

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Niko Peleshi**

**VENDIM**

**Nr. 355, datë 19.4.2017**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME  
NË VENDIMIN NR.408, DATË 13.5.2015,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES SË  
ZHVILLIMIT TË TERRITORIT",  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin e rregullore së zhvillimit të territorit, bashkëlidhur vendimit nr.408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas shkronjës "dh", të nenit 17, shtohet shkronja "e", me këtë përmbajtje:

"e) ndryshime që rezultojnë në ndryshimin e sipërfaqes ndërtimore të objektit, mbi tokë dhe nën tokë, brenda kufijve dhe kushteve urbane të zhvillimit, me kusht që ndryshimi i sipërfaqes ndërtimore mbi tokë të mos tejkalojë masën 2% të sipërfaqes ndërtimore mbi tokë të miratuar në lejen e ndërtimit."

2. Shkronja "sh", e pikës 1, të nenit 19, shfuqizohet.

3. Në fund të pikës 1, të nenit 27, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Ndryshimi i sipërfaqes ndërtimore të përgjithshme, që konstatohet në përfundim të punimeve të ndërtimit të një objekti të ri, nuk konsiderohet shkelje, por marzh gabimi, në rast se nuk tejkalon masën 1% të sipërfaqes ndërtimore të përgjithshme të lejuar me lejen e ndërtimit, me kusht që ndërtimi të jetë në përputhje me kushtet e tjera urbane të zhvillimit."

4. Pika 7, e nenit 34, shfuqizohet.

5. Në fund të nenit 45/1 shtohet neni 45/2, me këtë përmbajtje:

"Neni 45/2

**Aktet e konformitetit nga KKT-ja**

Për çdo aplikim për leje ndërtimi për objektet mbi 9 kate, autoritetet vendore të zhvillimit në çdo rast duhet të marrin paraprakisht aktin e konformitetit nga KKT-ja. Procedura për dhënien e aktit të konformitetit përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit."

II. Afatet e parashikuara në rregullore llogariten në ditë pune.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Niko Peleshi**